



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000180

Tiranë ___/___/2020

Lënda : Rekomandohet vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar nga z. ***

Drejtuar : KËSHILLIT BASHKIAK PRANË BASHKISË KAMËZ

BASHKISË KAMËZ

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është regjistruar një ankesë nga shtetasi z. ***, i cili parashtron se i është mohuar e drejta për informim mbi dokumentet publike nga Këshilli Bashkiak (KB) Kamëz, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe aktet e brendshme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e këtij organi.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore të formës dhe përmbajtjes për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/b, ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, kemi kërkuar nga Këshilli Bashkiak pranë Bashkisë Kamëz të na përcillen shpjegime me shkrim lidhur me rastin në

fjalë, bazuar në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) “të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*.

• Rrethanat e rastit

1. Ankuesi është anëtar i Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Kamëz, i mandatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendim nr.1102, datë 05.12.2019.
2. Më datë 13.12.2019 ai ka depozituar një kërkesë për informacion sipas formularit “kërkesë për informacion”, pranë Këshillit Bashkiak Kamëz, ku ka kërkuar procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak si dhe kopje të njoftimeve për mbledhjet e KB (datën, orën dhe rendin e ditës), për periudhën 1 Gusht 2019-11 Dhjetor 2019.
3. Më datë 27.12.2019, Sekretarja e Këshillit Bashkiak i ka kthyer përgjigje kërkesës për informacion, duke kërkuar specifikimin e numrit të vendimit të kërkuar dhe datën e tij, dhe duke theksuar se rendi i ditës është dërguar gjithmonë në mënyrë elektronike.
4. Më datë 08.01.2020 ankuesi i është drejtuar sërish KB, duke saktësuar kërkesën për informacion si më poshtë:
*Në bazë të nenit 9, pika 2 dhe nenit 14 të rregullores së Keshillit Bashkiak Kamëz, më duhet informacionet e parashikuara në pikën 1 të nenit 49, të sipercituar më lart në email, për periudhën 7 Gusht 2018 e deri më tani.
Bëhet fjalë për vendimet që fillojnë nga data 7/08/2019 (vendimi mbi ngritjen e komisionit të verifikimit të mandateve të anetareve të keshillit bashkiak), në të cilën jeni emeruar dhe sekretare, e në vazhdim. Duke qënë se rendet e ditës të mbledhjeve të këshillit bashkiak nuk më kanë ardhur me email, do ju lutesha një kopje të rendeve ose nje forëard të emaileve që keni derguar anetareve të tjerë të këshillit bashkiak, perkundrazi besoj se jeni duke keqinformuar dhe shkelur mbi parimet bazë ndaj te cilave jeni betuar.*

5. Më datë 18.02.2020 pranë institucionit të Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa ku parashtrohet problematika dhe kërkohet ndërhyrja e institucionit tonë për zgjidhjen e saj.
6. Më datë 24.02.2020, me shkresën nr. 1573 Këshilli Bashkiak i kthyer përgjigje kërkesës për informacion. Në këtë përgjigje thuhet ndër të tjera se: “...mandati juaj është dhënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 05.12.2019 dhe informacioni i kërkuar nga ana juaj në cilësinë e Këshilltarit Bashkiak mund t’ju vihet në dispozicion vetëm për periudhën nga data 05.12.2019 e në vazhdim ...”.
7. Më datë 01.03.2020 ankuesi i është drejtuar institucionit tonë në rrugë elektronike duke u shprehur se *përgjigja e dhënë në datë 24/02/2020 nuk përmban as informacionin e kërkuar dhe as informacion e cituar nga vetë personat që kanë shkruar përgjigjen. Nuk përmban asnjë nga procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes së këshillit bashkiak; Nuk përmban kopje të njoftimeve të bëra nga ana e sekretares së këshillit bashkiak.*

- **Analiza e institucionit të Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime**

- ❖ *Veprimet administrative të institucionit të Avokatit të Popullit, pas regjistrimit të ankesës*

Pas regjistrimit të kësaj ankese, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë kryer veprimet administrative si më poshtë:

1. Me tonën nr. K3/F2-2, datë 25.02.2020 i jemi drejtuar Këshillit Bashkiak Kamëz me kërkesë për informacion;
2. Me tonën nr. K3/F2-3, datë 25.02.2020 kemi informuar ankuesin lidhur me fillimin e hetimit administrativ;
3. Me shkresën nr. 1714/1, datë 05.03.2020 Këshilli Bashkiak ka përcjellë shpjegimet lidhur me rastin. Në këtë përgjigje të institucionit përgjegjës thuhet ndër të tjera se:

- ❖ *Legjislacioni i aplikueshëm*

Institucioni i Avokatit të Popullit nisur nga natyra e kërkesës së ankuesit, vlerëson se ajo është tepër komplekse dhe si e tillë duhet të trajtohet në mënyrë të kujdesshme, duke harmonizuar njëkohësisht dispozitat e

legjislacionit për vetqeverisjen vendore, të legjislacionit për të drejtën e informimit, si edhe të veprimtarisë administrative në përgjithësi.

E drejta e informimit për dokumentet zyrtare është një e drejtë e individit e cila lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procedurave administrative. Për këtë arsye ajo është një e drejtë e mbrojtur dhe garantuar nga aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10). Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh për të drejtën e informimit, të cilat janë tregues i kuptimit që ka ky organizëm mbi këtë çështje, dhe që shërbejnë si udhërrëfyes për vendet anëtare për rregullimin e kësaj të drejte. Po kështu, nisur nga rëndësia parësore që e drejta informimit ka për zhvillimin e demokracisë së një vendi, Këshilli i Evropës ka miratuar një Konventë të posaçme "Për aksesin në dokumentet zyrtare".

E drejta e informimit është sanksionuar edhe në rendin e brendshëm të juridik të Republikës së Shqipërisë, pasqyruar në Kushtetutën e RSH (neni 23)¹, në Kodin e Procedurave Administrative (neni 6)² dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23 sanksionon se:

- 1. E drejta e informimit është e garantuar.*
- 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*
- 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive*

Kodi i Procedurave Administrative (neni 6) sanksionon se:

- 1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.*

¹ 1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive

² 1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. 2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Ligji nr. 119/2014, rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike (neni 1 i ligjit).

Institucioni ynë vlerëson se për të adresuar drejt e në përputhje me dispozitat ligjore rastin, është e nevojshme të arsyetohet qartë dallimi mes “*Informacionit publik*” në kuptim të legjisacionit për të drejtën e informimit, dhe akteve të prodhura gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga organet kolegjiale të administratës publike, siç është Këshilli Bashkiak.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 2, pika 2 përcakton se: “*informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”. Nisur nga ky përkufizim, duket se aktet e prodhuara nga organi kolegjial Këshilli Bashkiak në ushtrim të veprimtarisë administrative janë informacion publik. Megjithatë pavarësisht sa më lart, e drejta e informimit nuk është një e drejtë e pakufizuar, e pikërisht për këtë arsye legjislatori në dispozitën e nenit 17 të ligjit të sipërcituar ka parashikuar shprehimisht edhe rastet e kufizimit të kësaj të drejte:

1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

- a) të drejtën për një jetë private;*
- b) sekretin tregtar;*
- c) të drejtën e autorit; ç) patentat.*

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;

c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;

d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;

dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;

e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;

ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2, të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij neni, nuk zbatohet kur hetimi administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor, dhe procedurat e inspektimit e të auditimit të autoriteteve publike kanë përfunduar.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat “d” dhe “dh”, të këtij neni, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore.

Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronja “e”, të këtij neni, nuk zbatohet pasi politikat janë bërë publike.

3. E drejta e informimit kufizohet, nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji.

4. E drejta e informimit kufizohet edhe kur, pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar.

5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e

informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni.

6. *Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.*

7. *Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji, pavarësisht nga parashikimet e ligjit për arkivat.*

Në rastin në fjalë, dokumentacioni objekt i kërkesës për informacion nuk është vetëm objekt i ligjit të sipërcituar, por edhe i legjislacionit të posaçëm për organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore.

Organizimi dhe funksionimi i njësive të qeverisjes vendore, funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë disiplinohen nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Transparenca e organeve të qeverisjes vendore gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative është një element i cili trajtohet në mënyrë të posaçme nga ky ligj. Nenet 15 e vijues të ligjit të sipërcituar shprehen ndër të tjera se:

- ❖ Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre³;
- ❖ Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike⁴;
- ❖ Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes⁵;
- ❖ Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit⁶;

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se mosrespektimi i të gjithë dispozitave të cituara më lart nuk përbën ngushtësisht vetëm moszbatim të kërkesave të ligjit, por është tregues i qasjes që ka institucioni në drejtim të praktikave të mira administrative, në përputhje me parimet e efijencës dhe ndihmës aktive që organi publik i jep palëve të treta.

³ Neni 15, pika 1

⁴ Neni 15, pika 2

⁵ Neni 16, pika 1

⁶ Neni 17, pika 1

Dispozitat e mësipërme synojnë ndërgjegjësimin e institucioneve publike për trajtimin e kërkesave për informacion, në përputhje me parimet e veprimtarisë administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative (KPrA). E drejta e informimit në Kodin e Procedurave Administrative, përveçse shfaqet si një parim i veçantë (neni 6), harmonizohet në tërësi me parimet në të cilët organet publike duhet t'a bazojnë veprimtarinë administrative, veçanërisht me parimin e dhënies së ndihmës aktive dhe parimin e deburokratizimit e efijencës (nenet 10 dhe 18 të KPrA).

Në rastin konkret vërejmë se ankuesi më datë 13.12.2019 ka depozituar një kërkesë për informacion sipas formularit “kërkesë për informacion”. Bazuar në këtë kërkesë, më datë 27.12.2019, pra pas 14 ditësh ankuesit i është kthyer një përgjigje nga Sekretarja e Këshillit Bashkiak. Në këtë përgjigje e cila për nga përmbajtja nuk justifikon kohën e gjatë në dispozicion për kthimin e një përgjigje ankuesi, kërkohet specifikimi i numrit të vendimit të kërkuar dhe data e tij dhe theksohet se rendi i ditës është dërguar gjithmonë në mënyrë elektronike.

Procedurat e shpejta dhe efikase nxiten edhe nga delegimi i përmirësuar i kompetencave vendimmarrëse brenda organeve të administratës publike, ndaj në këtë kuptim ligji ka për qëllim që t'i garantojë kërkuesit për informacion të drejtën për të marrë pjesë në një procedurë administrative efijente. Kjo kërkon jo vetëm një sjellje të punonjësve publikë të orientuar drejt shërbimit, por edhe kryerjen e procedurave “sa më efektive dhe sa më lehtë të jetë e mundur”. Organi publik “siguron” që palëve t'u jepet çdo ndihmë, veçanërisht të gjitha informacionet e nevojshme për “ndjekjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre ligjore” (neni 10 i KPrA). Këto parashikime të dispozitave të legjislacionit procedural administrativ përbëjnë parime, të cilat duhet të materializohen duke përdorur diskrecionin procedural dhe organizativ gjatë kryerjes së procedurave administrative. Parimi i shpejtësisë dhe efektivitetit nuk përjashton ekzistencën e disa hapave thelbësorë proceduralë që mund të jenë pak a shumë formalë, kur është e nevojshme për të garantuar ligjshmërinë dhe themelin e veprimit përfundimtar, në përputhje me parimet administrative të hapësirës administrative evropiane. Shteti i së drejtës është parimi mbizotërues për të gjitha veprimet administrative, e theksuar kjo në mënyrë të shprehur në nenin 4 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas së cilës zhvillimi i një procedure administrative në përputhje me të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës, përbën në thelb të drejtën për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative.

Detyrimi i organeve të administratës publike për dhënien e ndihmës aktive dhe respektimin e parimit të deburokratizimit dhe efijencës në procedurat administrative duhet të konsiderohet si pjesë thelbësore e “administrimit të

mirë” dhe e kërkesave të akteve ndërkombëtare dhe të Kushtetutës së Shqipërisë në fushën e të drejtës për informimin e qytetarëve.

❖ *Analiza e rastit konkret*

Pas përgjigjeve të përcjella nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak në drejtim të ankuesit⁷, në analizë të legjislacionit në fuqi si më lart institucioni i Avokatit të Popullit konstaton dhe vlerëson sa më poshtë vijon.

Qendrimi i mbajtur nga Këshilli Bashkiak Kamëz në dy përgjigjet përkatësisht të datave 13.12.2019 (në rrugë elektronike) dhe 24.02.2020 (me shkresën nr. 1573), nëpërmjet së cilave Sekretaria e KB fillimisht i drejtohet ankuesit për specifikimin e numrit të vendimit të kërkuar dhe datën e tij, duke theksuar se rendi i ditës është dërguar gjithmonë në mënyrë elektronike, e më pas i kthen atij përgjigje se informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar do të vendoset në dispozicion vetëm për periudhën gjatë së cilës ai ka ushtruar funksionin e anëtarit të Këshillit Bashkiak, përbën mosrespektim të të drejtës për informim. Në rastin në fjalë, nuk gjejmë në aktin administrativ nr. 1573, datë 24.05.2020 të Kryetarit të Këshillit Bashkiak asnjë argument që të arsyetojë kufizimin e të drejtës së kërkuarit për informim, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Një nga parimet kryesore ku njesitë e vetqeverisjes vendore duhet t’u mbështesin veprimtarinë e tyre administrative është pikërisht transparencja dhe informimi i publikut. Kjo do të thotë, se e drejta e informimit mbi diskutimet gjatë mbledhjeve të organeve kolegjiale siç është Këshilli Bashkiak, përdërisa nuk i kufizohet qytetarëve, patjetër që nuk mund t’i kufizohet as anëtarëve të këtij organi kolegjial, siç mendojmë se pa të drejtë ka vepruar institucioni në këtë rast⁸.

Në shkresën nr. 1714/1, datë 05.03.2020 të Këshillit Bashkiak drejtuar Avokatit të Popullit theksohet ndër të tjera se: “ ... *personi në fjalë këtë dokumentacion e ka kërkuar në cilësinë e këshilltarit të Këshillit Bashkiak dhe jo në cilësinë e qytetarit*⁹...”. Institucioni citon Rregulloren e Brendshme të Këshillit Bashkiak Kamëz, si bazë për kufizimin e të drejtës së ankuesit për t’u informuar për dokumentacionin administrativ të prodhuar gjatë veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, para datës së mandatimit të tij. Kështu, Këshilli Bashkiak ndonëse nuk na ka vendosur në dispozicion

⁷ Shiko pikat 3 dhe 5 të rrethanave të faktit

⁸ Shiko pikën 5 të rrethanave të faktit

⁹ Faqe 2, pragrafi 1 i shkresës nr. 1714/1, datë 05.03.2020 të Këshillit Bashkiak drejtuar Avokatit të Popullit

një kopje të rregullores, dhe as nuk e ka atë të publikuar në faqen zyrtare të internetit¹⁰, citon rregulloren si më poshtë:

“Këshilltarët e Bashkisë që duan të marrin informacione të nevojshme për kryerjen e funksionit gjatë mandatit të tyre, i drejtohen në çdo kohë Sekretarit të Këshillit të Bashkisë, përgjegjësve të ndërmarrjeve apo institucioneve në varësi të Bashkisë, por edhe Kryesisë së Këshillit apo Drejtorive të shoqërive të përbashkëta për aktet e të cilave Këshilli i Bashkisë duhet të shprehet”

Në këtë dispozitë të cituar nga Këshilli Bashkiak si bazë ligjore për kufizimin e të drejtës së ankuesit për informim nuk shohim në fakt ndonjë kufizim konkret për të drejtën e anëtarëve të Këshillit Bashkiak për t’u njohur me aktet e prodhuara nga ky organ kolegjal para mandatimit të tyre. As ligji nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, siç është cituar më lart¹¹, nuk ka ndonjë kufizim për këtë çështje, përkundrazi siç u shprehëm në pjesën arsyetuese të legjislacionit të aplikueshëm në këtë rast, mendojmë se ligji ka për qëllim të nxisë sa më tepër transparencën e organeve publike në veprimtarinë administrative.

Transparenca dhe llogaridhënia e organeve të vetqeverisjes vendore janë dy parime të rëndësishme, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare.

Pikërisht në këtë kuadër, vetë Bashkia Kamëz në programin e transparencës ka parashikuar se¹²:

Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të: - Kalendarit të mbledhjeve të KB - Njoftimet për mbledhjen e KB - Rendin e ditës së mbledhjes së KB - Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB - Procesverbalet e mbledhjeve të KB - Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ.

¹⁰ Në faqen zyrtare të KB Kamëz, link https://kamza.gov.al/previewdoc.php?file_id=10767 me titull “Rregullorja e Këshilit Bashkiak”, dokumenti nuk është i akseueshëm.

¹¹ Shiko legjislacionin e aplikueshëm në këtë rekomandim, fq. 5

¹² <https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/modeli-i-transparences-1.pdf>, fq.5, pika 3

Në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz, tek pjesa që i takon Këshillit Bashkiak, por edhe në pjesët e tjera të kësaj faqe, pjesa më e madhe e dokumentacionit të cituar më lart nuk janë të publikuara.

Një anëtar i ri të një organi kolegjal, në rastin konkret anëtarit të ri të Këshillit të Bashkiak (siç është ankuesi) jo vetëm që nuk mund t'i mohohet e drejta për informim, përkundrazi mendojmë se aksesit në informacion duhet t'i garantohet si një mjet efektiv që i lejon atij të ushtrojë funksionin publik me të cilin është mandatuar. Edhe vetë rregullorja e cituar në përgjigjen e dërguar nga Këshilli Bashkiak e shpreh qartë këtë: “ ... *Këshilltarët e Bashkisë që duan të marrin informacione të nevojshme për kryerjen e funksionit gjatë mandatit të tyre ...*”.

Ndryshe nga sa ka vlerësuar Këshilli Bashkiak, se ankuesi e ka depozituar kërkesën si është anëtar i Këshillit Bashkiak dhe jo si qytetar, mendojmë se pikërisht fakti se ai është anëtar i këtij organi kolegjal duhet të shërbejë akoma më tepër si shkas e shtysë që atij t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, pasi kështu do të mund të njihet me praktikën administrative të ndjekur më parë, por edhe me qëllimin e vendimmarrjeve të ndryshme. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak nuk mund të jenë sekret për sa kohë që, për analogji, as procesverbalet e mbledhjeve të Komisioneve Parlamentare, apo relacionet e projektligjeve të ndryshme nuk janë të tilla, përkundrazi gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit të RSH, me qëllimin për t'i shërbyer jo vetëm funksionarëve publikë, por edhe të gjithë qytetarëve.

Madje, edhe nëse ankuesi do t'a kishte depozituar kërkesën si qytetar, nuk do të kishte vend për kufizimin e saj, pasi informacioni i kërkuar, referuar vet programit të transparencës të Bashkisë, siç e shpjeguam, duhet të ishte publik.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike*”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen*”,

REKOMANDOJMË:

- Këshilli Bashkiak pranë Bashkisë Kamëz të vendosë në dispozicion të ankuesit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar (*procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak si dhe kopje të njoftimeve për mbledhjet e KB (datën, orën dhe rendin e ditës), për periudhën 1 Gusht 2019-11 Dhjetor 2019*), në formën e kërkuar nga ligji, duke marrë masat e nevojshme për të vërtetuar vendosjen reale në dispozicion të çdo akti individualisht, në përputhje me rregullat e procedurës administrative dhe të shërbimit arvikor në Republikën e Shqipërisë;
- Bashkia Kamëz të marrë masat e nevojshme për të publikuar në faqen zyrtare të internetit të gjithë informacionin, siç parashikohet në programin e transparencës së këtij institucioni, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Bashkia Kamëz të marrë masat që këto mangësi të mos konstatohen më në të ardhmen;
- Bashkia Kamëz të marrë masat e nevojshme për trajnimin e personelit përkatës me njohuritë e përshtatshme për kuadrin ligjor, konkretisht, ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi të njoftohemi për masat apo veprimet e ndërmarra nga Këshilli Bashkiak pranë Bashkisë Kamëz, si dhe nga Bashkia Kamëz.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

K O M I S I O N E R I

Prof. Asoc. Dr., Erjona BANA (CANAJ)